



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1459/12

Datë 02.07.2024

V E N D I M
Nr. 780/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.07.2024 mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.729/2024, datë 21.06.2024 për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-07644-05-31-2024, me objekt: “Loti I. Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues”, me fond limit 21,735,949.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, me Nipt (M11815028I), me adresë: Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara., me adresë: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nr.3 , Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1 Në datën 21.06.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 729/2024, ku vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-07644-05-31-2024, me objekt: “Loti I. Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues”, me fond limit 21,735,949.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.*
 2. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
 3. *Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
 4. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
 5. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK .*
 6. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.*
 7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I2. Me anë të shkresës nr. 355/25 prot., datë 26.6.2024 protokolluar me tonën nr. 1459/8 prot., date 27.06.2024 , autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara njofton lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 729/2024 duke cituar se “O.B.P pas njohjes me vendimin Nr.729/2024 të KPP-se, protokolluar me tonën me nr.355/24 prot., date 26.06.2024, në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të dispozitivit të vendimit KPP ka vendosur sa më poshte: 1. Te mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK, për procedurën e prokurimit "E hapur", me Nr. REF07644- 05-31-2024, me objekt: "Loti I. Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues", me fond limit 21,735,949.00 leke (pa TVSH), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 18.06.2024 nga Autoriteti Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara. 2. Te pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "Albanian Distribution Chemicals" sh.p.k, për procedurën e mësipërme të prokurimit. 3. Autoriteti Kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve. 4. Autoriteti Kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi. Referuar dispozitivit të vendimit,

Komisioni i Prokurimit Publik ka pranuar pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik ankimes, si dhe ka vendosur që Autoriteti Kontraktor Operatori i Blerjeve të Pergendruara të kryejë modifikimet perkatëse në perputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve. Referuar pjesës arsyetuese, seksioni III pika 4.6, Komisioni i Prokurimit Publik ka pranuar pretendimin e ankimesit për të ndarë në lote procedurën e prokurimit objekt ankimi me Nr. REF- 07644-05-31-2024, me objekt Loti I. Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues". Për të bërë të mundur zbatimin e vendimit tuaj ishte e domosdoshme që kjo procedurë prokurimi të anulohet, pasi në fazën në të cilën ndodhet procedura nuk mund të behen modifikimet perkatëse për ndarjen në lote, në perputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik. Sa më sipër, kërkojmë lehtësim për anulimin e procedurës së prokurimit me Nr. REF-07644- 05-31-2024, me objekt Loti I. Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues", me fond limit 21,735,949.00 leke pa TVSH, me gëllim vazhdimin e zbatimit të vendimit Nr.729, datë 21.06.2024, për të bërë të mundur ndarjen në lote sipas vendimit tuaj dhe ri-hedhjen e procedurës së sipërcituar.

I.3 Me anë të informacionit të depozituar pranë Komisionit Prokurimit Publik autoriteti kontraktor njofton se ka kryer modifikimet përkatëse.

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me anë të shkresës nr. 355/25 prot., datë 26.6.2024 protokolluar me tonën nr. 1459/8 prot., date 27.06.2024 , autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara njofton lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 729/2024 duke cituar se “O.B.P pas njohjes me vendimin Nr.729/2024 të KPP-se, protokolluar me tonën me nr.355/24 prot., date 26.06.2024, në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të dispozitivit të vendimit KPP ka vendosur sa më poshtë: 1. Të mbyllë gështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik "Albania Distribution Chemicals" SHPK, për procedurën e prokurimit "E hapur", me Nr. REF07644- 05-31-2024, me objekt: "Loti I. Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues", me fond limit 21,735,949.00 leke (pa TVSH), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 18.06.2024 nga Autoriteti Kontraktor Operatori i Blerjeve të Pergendruara. 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "Albanian Distribution Chemicals" sh.p.k, për procedurën e mësipërme të prokurimit. 3. Autoriteti Kontraktor të kryejë modifikimet perkatëse në perputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve. 4. Autoriteti Kontraktor brenda 5 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi. Referuar dispozitivit të vendimit, Komisioni i Prokurimit Publik ka pranuar pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik ankimes, si dhe ka vendosur që Autoriteti Kontraktor Operatori i Blerjeve të Pergendruara të kryejë modifikimet perkatëse në perputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve. Referuar pjesës arsyetuese, seksioni III pika 4.6, Komisioni i Prokurimit Publik ka pranuar pretendimin e ankimesit për të ndarë në lote procedurën e prokurimit objekt ankimi me Nr. REF- 07644-05-31-2024, me objekt Loti I. Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues". Për të bërë të mundur zbatimin e vendimit tuaj ishte e domosdoshme që kjo procedurë prokurimi të anulohet, pasi në fazën në të cilën ndodhet procedura nuk mund të

behen modifikimet perkatise per ndarjen ne lote, ne perputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësiperme te Komisionit te Prokurimit Publik. Sa me siper, kerkojme lejimin per anullimin e procedures se prokurimit me Nr. REF-07644- 05-31-2024, me objekt Loti I. Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues", me fond limit 21,735,949.00 leke pa TVSH, me qellim vazhdimin e zbatimit te vendimit Nr.729, date 21.06.2024, per te bere te mundur ndarjen ne lote sipas vendimit tuaj dhe ri-hedhjen e procedures se sipërcituar.

II.2 Me anë të informacionit të depozituar pranë Komisionit Prokurimit Publik autoriteti kontraktor njofton se lidhur me vendimin Nr. 729/2024 të KPP duke qënë se në arsyetimin e kryer ne këtë vendim Komisioni Prokurimit Publik është shprehur për ndarjen në lote të procedurës, autoriteti kontraktor kërkon lëjimin për anullimin e procedurës pasi ne fazen ne te cilen ndodhet procedura nuk mund te behen modifikimet perkatëse per ndarjen ne lote.

II.3 Sa me siper, Komisioni Prokurimit Publik lidhur me arsyetimin e dhënë nga ana e autoritetit kontraktor lejon heqjen nga pezullimi me vijim anulimin e procedures objekt prokurimi në mbështetje të arsyetimit të dhënë në vendim Nr 729/2024 për ndarjen në lote.

Përsa më siper, referuar te ligjit nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik", nenit 31 te Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit te Prokurimit Publik" Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm për anulimin e procedurës objekt ankimi “E hapur”, me Nr. REF-07644-05-31-2024, me objekt: “Loti I. Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues”, me fond limit 21,735,949.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti Kontraktor me rishalljen e procedurës të sjellë dokumentacionin në zbatim të vendimit të KPP Nr 729/2024 datë 21.06.2024.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencise së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri